



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGJE**

Titulli i Modullit: Gjuhë Frënge për turizëm
Lloji i Trajnimit: Trajnim i zhvilluar në formë hibride.
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: Frëngjisht
Kohëzgjatja e programit të modullit: 40 orë
Nr. i krediteve: 4 ECTS

Mënyra e zhvillimit: Nëpërmjet metodave aktive dhe pjesëmarrjes në diskutime, puna në grup, studimeve të rasteve dhe lojërave me role, praktikimit të koncepteve të paraqitura nga trajneri nëpërmjet aktiviteteve mësimore.

PËRMBLEDHJE E MODULLIT:

Ky modul formimi është hartuar mbi aspekte kyçe të shërbimit ndaj klientit në kontekstin e turizmit duke përfshirë komunikimin, logjistikën, dhe ndërveprimin kulturor dhe ofron një qasje gjithëpërfshirëse për formim në shërbimin ndaj klientit. Duke investuar në këto njohuri dhe aftësi, organizatat do të jenë më të përgatitura për të ofruar shërbime të ndryshme dhe për të përmbushur pritshmëritë e klientëve në mënyrë efektive dhe profesionale.

Moduli ofron njohuri mbi organizimin e pritjes, si nga aeroporti deri në klinikë, organizimin e vizitave me guide për klientet, aspekte nderkulturore etj.. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për sigurimin e një eksperiencë të përshtatshme dhe pa stres për klientët, duke minimizuar çdo shqetësim që ata mund të kenë. Njohuritë mbi procedurat e klinikës dhe mënyrën e ndërveprimit me klientët ndihmojnë në krijimin e një ambienti profesional dhe të besueshëm, ku klientët ndihen të sigurt dhe të respektuar.

Pjesa e terminologjisë është gjithashtu thelbësore për të siguruar që pjesëmarrësit të njohin fjalorin teknik të fushës, duke rritur kështu efikasitetin e komunikimit dhe shërbimeve.

REZULTATET E TË NXËNIT:

- përmirësimi i komunikimit me klientët;
- organizimi i pritjes nga aeroporti në klinikë;
- manaxhimi i aspekteve si logjistika dhe transporti;
- pritja në klinikë dhe prezantimi i klinikës;
- organizimi i një itinerari turistik për klientët;
- të kuptuarit e aspekteve kulturore në shkëmbimet e ndryshme me klientët;
- të përvetësuarit e terminologjisë së duhur për temat e trajtuara;
- të shprehurit me shkrim dhe me gojë lidhur me temat e trajtuara.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

- përmirësimi i komunikimit me klientët;
- organizimi i pritjes nga aeroporti në klinikë;
- manaxhimi i aspekteve si logjistika dhe transporti;
- pritja në klinikë dhe prezantimi i klinikës;
- organizimi i një itinerari turistik për klientët;
- të kuptuarit e aspekteve kulturore në shkëmbimet e ndryshme me klientët;
- të përvetësuarit e terminologjisë së duhur për temat e trajtuara.